



Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Prodate Received / Delivery	29.11.2022	2	viti god year
Organ / Jësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/MBK	7489/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.916/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.916/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese: kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "kërkese nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.11.2022, njëzëri, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.916/2022 e datës 14.10.2022 parashtruar nga ankuesi
- II. **REFUZOHET** pretendimi i ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit në mënyre retroaktive nga data 01.08.2021 .
- III. **OBLIGOHET** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 14.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6186/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa, kjo e fundit më datë 10.11.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6186/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për harmonizimin e pagave të shërbyesve civil me numër të protokollit 6793 të datës 05.09.2022; Emalin datës 15.09.2022 të drejtuar ankuesit për përgjigje në kërkesë; Akt emërimit me numër të protokollit 7198/1 të datës 20.10.2021; Vendimin me numër Ref.AUV-01/562/2021 të datës 20.10.2021 lidhur me transferimin e ankuesit nga Komuna e Mitrovicës në AUV; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 6998/2022 të datës 10.11.2022 nga Njësia e personelit të AUV, drejtuar Këshillit; E-malin e datës 09.3.2022 të drejtuar përgjigje në kërkesë për harmonizimin të koeficientit të pagës/AUV; E-malin datës 02.03.2022 të drejtuar Kërkesë për harmonizim të koeficientit; E-mail i datës 01.4.2022 të drejtuar përgjigje në kërkesë për harmonizimin të koeficientit të pagës/AUV; E-malin e datës 09.3.2022 të drejtuar përgjigje në kërkesë për harmonizimin të koeficientit të pagës/AUV; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar , kërkesë për harmonizimin të koeficientit për inspektor e komunës të transferuar në AUV; Emalin e datës 27.10.2022 të drejtuar kërkesë për harmonizimin të koeficientit për inspektor e komunës të transferuar në AUV; E-malin e datës 19.08.2022 të drejtuar kërkesë për harmonizimin të koeficientit për inspektor e komunës të transferuar në AUV; Kërkesë me numër të protokollit 5527 të datës 26.07.2022 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm në Thesarin e Kosovës, për harmonizimin të koeficientit për inspektor e komunës të transferuar në AUV; Shkresën me numër të protokollit 1444 të datës 28.03.2014 lidhur me procedimin e shtesës sipas pozitës-Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-ZKM-së; Formularin i datës 10.06.2022 e Shpenzimit të Departamentit, Divizionit ose Sektorit (planifikimi për vitin 2022) prej 1/6 faqe; Emalin e datës 19.08.2022 të drejtuar lidhur me sqarimin e koeficienteve për pozitën Inspektor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, gje gjësisht sipas Akt Emërimit me numër të protokollit 7198/1 të datës 20.10.2021, ankuesi është emëruar në pozitën "Inspektor Sanitar" në Drejtorinë e Inspektionit Sanitar, me koeficient gjashtë (6) të pagës. I njëjti me datën 05.09.2022 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 6793 të Udhëheqësi i Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për harmonizimin e pagave për shërbyesit civil (Inspektoreve). Ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë përmes emalit të datës 15.09.2022 i është përgjigjur kërkesës se ankuesit duke sqaruar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është duke bërë përpjekje maksimale për realizimin e kërkesës tuaj e cila është edhe kërkesë e AUV-së, dhe se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është në procese të zgjedhjes së kësaj çështje po që kjo varet

ekskluzivisht nga Ministria e Punëve të Brendshme, konkretisht Divizioni për Menaxhimin e Zyrtareve Publik.

Ne ankesën e datës 14.10.2022 të parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ankuesi pretendon që ti bëhet harmonizimi i koeficientit nga koeficienti aktual gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) si dhe kompensimin retroaktiv të pagës nga dita e vendimit të transferimit konkretisht data 01.08.2021.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën e Inspektor Sanitar, Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: *"Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë"*. Andaj, mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën Inspektor Sanitar me koeficient gjashtë (6) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1.Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....* andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji gjen se organi i punësimit në këtë rast Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka ndërmarr të veprimet nevojshme për harmonizimin e koeficientit të ankuesit duke bërë kërkesë në ministrinë përgjegjëse për ekzekutimin për nivelizimin e koeficientit të pagës, mirëpo që kjo e fundit nuk ka ekzekutuar kërkesën në fjalë, andaj mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Kolegji me të drejtë vlerëson se ankuesi në kuptim të realizimit të së drejtës së pagës vazhdon të trajtohet në mënyrë me pak të favorshme se sa nëpunësit civilë të cilët ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës në institucionet tjera publike, rrjedhimisht nisur nga ekzistimi i këtyre fakteve rezulton së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të njëjta të punës, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*

Bazuar në shkresat e lëndës respektivisht në përgjigjen e dorëzuar nga organi i punësimit Kolegji ka gjetur shkresën me numër të protokollit 1444 të datës 28.03.2014 me të cilën Drejtori i DASHC-së

pranë Ministrisë së Administratës Publike i është drejtuar Menaxherit të Personelit si dhe Zyrtarit Kryesorë Financiar duke sqaruar pozitën e Inspektoreve se janë të planifikuara mjetet buxhetore atëherë pozita e punës inspektor duhet që të nivëlizohet, dhe paga bazë të jetë e njëjte për Inspektoret e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë gjegjësisht me koeficient të njëjte tetë (8).

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës për pozitën "Inspektor Sanitar" duke filluar nga data 01.08.2021 e tutje, Kolegji bazuar në provat e kësaj çështje nuk ka gjetur asnjë dëshmi se ankuesi pas nënshkrimit të Aktit të Emërimit me numër protokoll 7198/1 të datës 20.10.2021 të këtë ndërmarr ndonjë veprim juridik lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës apo heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e tij për harmonizim të koeficienti, kështu që Kolegji konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar dhe i parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, theksuar si me sipër, obligohet Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit ankuesit nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8).

Siç u theksua me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.916/2022

Zyle Milaku GOJNOVCI

Procesmbajtës

Malsore GASHI/BAJRAKTARI,

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.